



**Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale / Direktorat za Zdravstvo i Socijalnu
Zaštitu / Department of Health and Social Welfare**

Nr: 04-016/01-32405/22

Datë: 25/03/2022

Gj i l a n

Në bazë të Rregullores së Ministrisë së Financave Nr: 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nxjerr këtë :

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE

Për mbështetje financiare publike për projekte/programme, të organizatave jo-qeveritare në fushën e mirëqenies sociale.

-I-

1. Për implementimin e thirrjes publike, do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ^{ve}.
2. Mbështetja financiare publike për projekt/programet e OJQ^{ve}, nga Buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kodi ekonomik: **10/651 /7303622200/00000/0760 dhe kodi :21/ 7303622200/00000/0760** në kuadër të programit/nënprogramit/ të subvencioneve

-II-

1. Mjetet do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ^{ve}.

Sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes e cila është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

-III-

1.Dokumentacioni i zbatimit të thirrjes publike sipas pikës II, të këtij Vendimi përfshinë:

- 1. Tekstin e thirrjes publike**
- 2. Udhëzimin për aplikantët**
- 3. Formularët e aplikimit**
- 4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve**
- 5. Format për raportimin e zbatimit të projektit**

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1, të këtij neni janë:

- 1.Forma e përshkrimit të programit apo projektit**
- 2.Forma e buxhetit të programit apo projektit**
- 3.Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta**
- 4.Deklarata e partneritetit (nëse është e aplikueshme)**
- 5.Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ^{ve}, të financuara nga burimet publike**
- 6.Deklarata për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet)**

3.Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 1.Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit**
- 2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin**
- 3.Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit**

-IV-

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (veb faqe)

-V-

- 1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ^{te} dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijoj një komision vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.**
- 2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurimit sipas paragrafit 1, të këtij neni.**

3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ^{ve}.

-VI-

1. Pasi të merret Vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr Vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ^{ve}.

2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njëjtoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.

Përgjegjës për zbatimin e këtij Vendimi është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

-VII-

Ky Vendim hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe protokolimit

 **Drejtor**
/ Aurorë Osmani Buca /